

# **FORMULARI I MIRATIMIT DHE KUSHTET E PËRDORIMIT PËR APLIKANTËT KUNDREJT SHËRBIMEVE TË OFRUARA NGA QENDRA E APLIKIMIT PËR VIZË KANADEZE (QAVK) E IMPLEMENTUAR NGA VFS GLOBAL**

## **1. Shërbimet e QAVK-së**

QAVK-ja kryen një numër shërbimesh ndihmëse administrative si dhe kryen shërbimin e marrjes së të dhënave biometrike për klientët të cilët dëshirojnë të aplikojnë për të hyrë në Kanada.

Tarifat e shërbimeve të QAVK-së, sikurse janë afishuar, janë autorizuar nga Qeveria Kanadeze.

## **2. Përgjegjësia**

VFS Global, përfshirë QAVK, nuk është agjenci e Qeverisë Kanadeze. QAVK-ja është një njësi tërësisht e pavarur, që vepron nën një kontratë me Qeverinë Kanadeze dhe është subjekt i ligjeve të vendit ku ofrohen shërbimet.

VFS Global, përfshirë QAVK, është përgjegjëse për mbledhjen, përdorimin, ruajtjen, mbajtjen dhe mbrojtjen e gjithë informacioneve personale që janë nën kontrollin e saj.

## **3. Gjuha e shërbimit**

QAVK-ja ofron shërbimin dhe mban të gjitha komunikimet e saj në gjuhën Angleze, Franceze, si edhe në gjuhën dominante vendore.

## **4. Marrëveshje lidhur me informacionin personal**

Unë, si përdorues i shërbimeve të QAVK-së, kuptoj dhe bie dakord se:

E kam lexuar plotësisht këtë dokument. Unë kuptoj që QAVK mundëson vetëm shërbim administrativ për dorëzimin e aplikimit në IRCC dhe se ky shërbim jepet në dakordësi të termave dhe kushteve që janë vendosur në kontratën e VFS Global me Qeverinë e Kanadasë dhe të përshkurara në këtë dokument. Unë kuptoj që VFS Global nuk ka fuqi vendimmarrëse apo ndikuese mbi aplikimin për vizë.

Informacioni personal merret nga QAVK nën autoritetin e një kontrate ndërmjet VFS Global Services dhe Qeverisë Kanadeze, e cila përfshin respektimin e ligjeve të privatësisë në Kanada. Autoriteti i kontratës përfshin çdo nënkontraktor të aprovuar.

QAVK do të marrë prej meje dokumente dhe do të mbledhë informacion personal lidhur me mua vetëm për qëllime që kanë të bëjnë me shqyrtimin e aplikimit nga Qeveria Kanadeze për vizë, leje ose dokumente udhëtimi, përfshirë transferimin e këtyre dokumenteve dhe informacioneve në Qeverinë Kanadeze dhe anasjelltas.

Më tej, nëse kërkohet në “Pranimi për dorëzimin/mbledhjen jo të drejtpërdrejtë”, i jap miratimin QAVK-së, të marrë dokumentet e mia dhe informacionin personal nga personi përmendur konkretisht më poshtë.

Informacioni im personal mund të përfshijë formularin e aplikimit, dokumente mbështetëse, gjurmët e gishtave dhe fotografi së bashku me të dhëna të tjera biometrike, sipas kërkesës së Qeverisë Kanadeze. Informacioni im personal mund të përfshijë gjithashtu edhe të dhëna lidhur me aplikimin, identitetin, të dhënat biografike dhe detaje kontakti, përfshirë informacionet elektronike apo të dhëna të tjera lidhur me aplikimin tim.

Nën kontratën ndërmjet VFS Global dhe Qeverisë së Kanadasë, QAVK-ja duhet të respektojë parimet e fshehtësisë dhe mbrojtjes së të dhënave personale sikurse miratuar me ligje të ndryshme në Kanada. Unë kuptoj që nëse do të kem dyshime lidhur me përdorimin e të dhënave të mia personale nga QAVK, unë kam të drejtë të paraqes një ankim në Zyrën e Komisionerit të Privatësisë së Kanadasë, duke përdorur informacionin e kontaktit që më është dhënë nga QAVK.

Unë kuptoj se QAVK-ja do të mbledhë, përdorë, zbulojë dhe ruajë informacionin tim personal për aplikimin tim për të hyrë në Kanada, në përputhje me kushtet e kontratës së saj me Qeverinë Kanadeze për qëllimet e ndihmës në shërbimin administrativ dhe mbledhjes së të dhënave biometrike, kur është e nevojshme. Qeveria e Kanadasë ia ka ndaluar QAVK-së të përdorë apo zbulojë të dhënat e mia personale për qëllime të tjera pa miratim të IRCC dhe një gjë e tillë mund të ndodhë vetëm brenda parametrave të kërkuara ligjore.

EMRI & MBIEMRI (me shkronja shtypi): \_\_\_\_\_

ADRESA: \_\_\_\_\_

NUMRI I TELEFONIT: \_\_\_\_\_

ADRESA ELEKTRONIKE: \_\_\_\_\_

NËNSHKRIMI: \_\_\_\_\_

DATA: \_\_\_\_\_

NËNSHKRUAR NË: \_\_\_\_\_ (qyteti, shteti)

**Miratimi për dorëzimin dhe/ose mbledhjen jo të drejtpërdrejtë të të dhënave (për t'u plotësuar VETËM nëse përdoret agjenti i udhëtimit apo përfaqësuesi përveç vetë aplikuesit po dorëzon dhe / ose mbledh aplikimin për vizë apo vendimmarrjen)**

Unë jap miratimin tim që QAVK-ja në \_\_\_\_\_ (Qyteti, Shteti) të **japë/mbledhë** dokumentet e mia **nga/te**: \_\_\_\_\_

Emri i personit që dorëzon një aplikim ose mbledh vendimmarrjen në emrin tim:

\_\_\_\_\_

Marrëdhënia me aplikantin: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi i aplikantit: \_\_\_\_\_

Data: \_\_\_\_\_

**Deklarata duhet të nënshkruhet VETËM nga aplikuesit e ndihmuar prej personelit të VFS Global për plotësimin e formularin elektronik të aplikimit.**

Unë kam marrë ndihmën e personelit të QAVK për hedhjen e të dhënave të informacionit të aplikimit tim. Unë i kam paraqitur të gjitha informacionet dhe përgjigjet e kërkuara nga aplikimi. Kam lexuar formularin e aplikimit të plotësuar dhe shtypur, dhe deklaroj se informacioni i paraqitur është i vërtetë dhe se dokumentet që shoqërojnë aplikimin që po dorëzoj janë origjinale dhe nuk janë ndryshuar në asnjë lloj mënyre.

Emri & Mbiemri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

### **Aplikantët që dëshirojnë të japin të dhënat biometrike**

Unë konfirmoj që kam parë mjetin e vlefshmërisë dhe të kërkesës së të dhënave biometrike në faqen zyrtare të internetit të IRCC dhe do të jap të dhënat e mia biometrike në përputje me informacionin e siguruar nga faqja zyrtare e IRCC. Kam marrë këtë vendim me vullnetin tim të lirë dhe pa asnjë ndikim apo sugjerim nga stafi i QAVK.

Emër & Mbiemri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_

### **Aplikantët që NUK dëshirojnë të japin të dhënat biometrike**

Unë konfirmoj që kam parë mjetin e vlefshmërisë dhe të kërkesës së të dhënave biometrike në faqen zyrtare të internetit të IRCC dhe kam vendosur të mos jap të dhënat e mia biometrike. Kam marrë këtë vendim me vullnetin tim të lirë dhe pa asnjë ndikim apo sugjerim nga stafi i QAVK. Unë e kuptoj që kjo mund të rezultojë në refuzimin e aplikimit tim pa komunikim të mëtejshëm nga IRCC.

Emër & Mbiemri: \_\_\_\_\_

Nënshkrimi: \_\_\_\_\_ Data: \_\_\_\_\_